



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:205441

Datë: 28.06.2024

Numri i dokumentit: 05881425

KPPP.nr. 1552/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, gjyqtari Arnis Dumani, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Green Energy AD” SH.P.K., me numër unik identifikues 811187401, me seli në Gjilan rr. “Mulla Idrizi”, kundër debitorit “Mediteran Group” SH.P.K., me numër unik identifikues 810671835, me seli në Viti rr. “Tiranës”, duke vepruar sipas propesimit të debitorit ushtruar ndaj Urdhrit Përmbartimor P.nr.111/23, i lejuar me datë 06.09.2023, nga Përmbartuesi Privat, Përparim I. Xhelili në Gjilan, me datë 28.06.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET pjesërisht si i bazuar propesimi i debitorit “Mediteran Group” SH.P.K., ashtu që ANULOHET pjesërisht Urdhri Përmbartimor P.nr.111/23 i datës 06.09.2023 i lejuar nga Përmbartuesi Privat Përparim I. Xhelili, sa i përket Faturës me nr.333/23 të datës 04.08.2023 dhe Faturës me nr.332/23 të datës 04.08.2023 në lartësi prej 714.30€ (shtatëqind e katërbëdhjetë euro e tridhjetë cent).
- II. REFUZOHET pjesërisht si i pabazuar propesimi i debitorit “Mediteran Group” SH.P.K. ashtu që pjesa tjetër e Urdhrit Përmbartimor Urdhrit Përmbartimor P.nr.111/23, i lejuar me datë 06.09.2023, nga Përmbartuesi Privat Përparim I. Xhelili, sa i përket Faturës me nr. 581/23, të datës 19.05.2023, Faturës me nr.279/2 të datës 21.07.2023, Faturës me nr.274/23 të datës 19.07.2023, Faturës me nr.287/23 të datës 24.07.2023, Faturës me nr.307/23 të datës 29.07.2023 dhe Faturës me nr.345/23 të datës 08.08.2023, në lartësi prej 4,102.33€ (katër mijë e njëqind e dy euro e tridhjetë e tre cent), MBETET NË FUQI.
- III. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale

A r s y e t i m

Përmbauesi Privat Përparim I. Xhelili duke vepruar sipas propozimit për përmbaues të kreditorit “Green Energy AD” SH.P.K., mbi bazën e dokumenteve të besueshme, Faturës me nr. 581/23, të datës 19.05.2023 në shumën prej 640.03€, Faturës me nr.279/2 të datës 21.07.2023 në shumën prej 645.00€, Faturës me nr.274/23 të datës 19.07.2023 në shumën prej 636.70€, Faturës me nr.287/23 të datës 24.07.2023 në shumën prej 1,218.10€, Faturës me nr.307/23 të datës 29.07.2023 në shumën prej 470.00€, Faturës me nr.332/23, të datës 04.08.2023 në shumën prej 355.00€, Faturës me nr.333/23 të datës 04.08.2023 në shumën prej 360.00€ dhe Faturës me nr.345/23 të datës 08.08.2023 në shumën prej 492.50€ me të cilin ka detyruar debitorin që në emër të borxhit t’ia paguaj kreditorit shumën prej 4,816.63€ (katër mijë e tetëqind e gjashtëmbëdhjetë euro e gjashtëdhjetë e tre cent), si dhe shpenzimet e procedurës përmbauese nën kërcënimin e përmbauesit të dhunshëm. Në të kundërtën përmbauesi të realizohet përmes bllokimit të llogarive bankare, sekuestrimit, e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit, dhe me shitjen e tyre të bëhet inkasomi i borxhit në llogari të kreditorit.

Debitori, ndaj urdhrin mbi lejimin e përmbauesit ka paraqitur prapësim me të cilin e ka kundërshtuar në tërësi si të pa bazuar urdhrin përmbaues, me arsyetimin se propozimi për përmbaues ka shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës përmbauese si dhe konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Debitori më tutje sqaron se vlera e përmbauesit të cilën kreditori e ka cekur 4,816.63€ nuk është vlerë reale, pasi duke u bazuar në Analitikën e Klientit – raport zyrtar i deklaruar në ATK, debitori ka obligim shumën prej 2,533.31€. Më tutje debitori thekson se fatura nr.332/23 të datës 04.08.2023 në shumën prej 355.00€ dhe fatura nr.333/23 të datës 04.08.2023 në shumën prej 360.00€, nuk janë të pranuar nga debitori dhe nuk kanë as nënshkrimin dhe as vulën e pranimin nga debitori. Më tutje thekson se kreditori ka kontaktuar me debitorin, i cili e ka informuar se atë javë gjendet në pushim, duke i sugjeruar kreditorit që të pret deri sa të kthehet nga pushimi, me qëllim që të takohen dhe të bëjnë barazimin e kartelave dhe pjesën e obligimit që del, debitori do ta paguaj menjëherë. Andaj, gjykatës i ka propozuar që të aprovoj prapësimin e debitorit në tërësi si të bazuar dhe të shfuqizoj në tërësi urdhrin përmbaues të Përmbauesit Privat Përparim I. Xhelili, me numër, P.nr.111/23, i lejuar me datë 06.09.2023.

Përgjigje në prapësim ka paraqitur personi i paautorizuar, Selmon Sadiku avokat nga Gjilani, andaj, gjykata nuk i vlerësoi fare pretendimet e paraqitura në këtë përgjigje në prapësim.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, gjeti se prapësimi i debitorit është pjesërisht i bazuar, andaj vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se organi përmbartues ka lejuar përmbartimin bazuar në nenin 21 të LPP-së i cili përcakton se: *“Organi përmbartues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbartimin vetëm në bazë të dokumentit përmbartues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”*.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat në bazë të së cilave është lejuar urdhri për përmbartim, i plotësojnë kushtet për të qenë dokumente të besueshme dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara, në përputhje me nenin 29 dhe 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, me paragrafin 3 të po të njëjtit nen, përcaktohet se: *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “*, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, dhe sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Në rastin konkret, gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përmbartuesit privat bazohet në dokumentin e besueshëm, përkatësisht, Faturës me nr. 581/23, të datës 19.05.2023, Faturës me nr.279/2 të datës 21.07.2023, Faturës me nr.274/23 të datës 19.07.2023, Faturës me nr.287/23 të datës 24.07.2023, Faturës me nr.307/23 të datës 29.07.2023 dhe Faturës me nr.345/23 të datës 08.08.2023, të cilat i përmbajnë të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në këtë faturë, janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, është i përshkruar objekti i faturës, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe e njëjta është pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt, e cila vërtetohet nga vula e protokollimit të debitorit.

Rrjedhimisht, gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat e lartcekura i plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP, për zbatimin e përmbartimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që të njëjtat janë dorëzuar në origjinal, mbajnë vulën dhe nënshkrimin e pranimit të debitorit, andaj vendosi që të lë në fuqi Urdhrin Përmbartimor P.nr.111/23, të datës 06.09.2023, të lejuar nga Përmbartuesit Privat Përparim I. Xhelili, sa i përket shumës në lartësi prej 4,102.33€

Gjykata anuloi pjesërisht Urdhrin Përmbartimor P.nr.111/23, i lejuar me datë 06.09.2023, nga Përmbartuesi Privat Përparim I. Xhelili, lidhur me Faturën me nr.333/23 të datës 04.08.2023 dhe Faturën me nr.332/23 të datës 04.08.2023, për shkak se faturat e lartcekura nuk i plotësojnë kushtet ligjore për të qenë dokumente të besueshme për faktin se të njëjtat nuk janë pranuar nga debitori dhe nuk janë as të nënshkruara dhe as të vulosura dhe as nuk është bashkangjitur ndonjë dëshmi për ndonjë mënyrë tjetër të dorëzimit të faturave.

Andaj, gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat e lartcekura, në bazë të së cilave është lejuar urdhri për përmbartim, nuk i plotësojnë kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP-së.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit, duke lënë në fuqi pjesën tjetër të urdhrin P.nr.111/23 të datës 06.09.2023, sipas Faturës me nr. 581/23, të datës 19.05.2023 në shumën prej 640.03€, Faturës me nr.279/2 të datës 21.07.2023 në shumën prej 645.00€, Faturës me nr.274/23 të datës 19.07.2023 në shumën prej 636.70€, Faturës me nr.287/23 të datës 24.07.2023 në shumën prej 1,218.10€, Faturës me nr.307/23 të datës 29.07.2023 në shumën prej 470.00€ dhe Faturës me nr.345/23 të datës 08.08.2023 në shumën prej 492.50€, për faktin se faturat në bazë të së cilave është lejuar urdhri për përmbartim, i plotësojnë kushtet për të qenë dokumente të besueshme dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara, në përputhje me nenin 29 dhe 37 të LPP-së.

Lidhur me shpenzimet gjyqësore si në pikën IV të dispozitivit të këtij Aktgjykimi, gjykata vendosi sipas nenit 452 par.1 dhe 2 të LPK-së, duke marrë parasysh suksesin e arritur në procedurën gjyqësore, ashtu që vendosi që secila palë të bart shpenzimet e veta procedurale.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe duke u bazuar në nenin 71 dhe 73 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1552/23, datë 28.06.2024

Gjyqtari
Arnis Dumani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.